

ARSIMI SHQIP NË KOSOVË 1918 – 1945

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI

Nga

MARIGONA MEHMETI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“Hasan Prishtina”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

STUDIMET PASUNIVERSITARE – MASTER

DREJTIMI – KOHA E RE

Prishtinë, 2021

EKSPOZE E TEMËS

Arsimi shqip në Kosovë 1918 – 1945

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Kandidat: Marigona Mehmeti

Punimi më titull “Arsimi shqip në Kosovë 1918 – 1945, që po paraqesim, ka ardhur si përmbushje e një detyrimi që duhet ta kemi rreth ruajtjes së vlerave tona kulturore – historike, sidomos rreth zhvillimit të arsimit në shtetin tonë Kosovën, ku shqiptarët kanë qenë të shtypur nga forcat serbo-sllave gjatë shekullit të XX, por në veçanti ishte e shtypur populli shqiptarë në Kosovë në mes të dy luftërave botërore nga regjimi serbo-jugosllav.

Në Kosovë është trajtuar zhvillimi i arsimit në periudha të ndryshme kohore nga studiues të ndryshëm, nga të cilët veqojm: Jashar Regjepagiq, Sulltane Kojqini-Ukaj, pastaj Hajrulla Koliqi, Bajram Shatri, Abdylaziz Veseli etj. Veprat e tyre janë me vlerë për faktin se ato u bënë bazë e mirë e vazhdimit të studimit tim të mëtutjeshëm rrethë kësaj problematike.

Kosova ishte më e varfëra në ish Jugosllavisë, si dhe më shkollim më të ulët, pothuajse shumica analafabet nga se ishte halë në sy për okupatorin sllav para Luftës së Dytë Botërore nuk kishte fare shkolla të hapura në gjuhën shqipe. Ato fillojnë të hapen pas pushtimit të Jugosllavisë nga forcat nazi-fashiste. Kështu përkundër të keqës që ndodhi në botë ishte një dritare e vogël e hapur për zhvillimin e dijës dhe arsimimit në gjuhën shqipe.

Nga gushti i vitit 1941, kur zona italiane u bashkua me Shqipërinë, filloi një epokë e re për arsimin shqip, që me të drejtë mund të cilësojmë si “Periudha e Artë”e zhvillimit të arsimit shqip në Kosovë. Këtë e themi për faktin se me dekret shtetëror u vendos që të ndihmohej arsimi në Kosovë, duke sjellë mësuesit e parë mbi (300) që të hapnin shkollat shqipe, pastaj ata organizuan edhe kurset e shkrim-leximit, etj.

Në këtë kuadër një trajtim të veçantë i’u është dhënë edhe ardhjes së mësuesëve nga Shqipëria, të cilët në mënyrë të organizuar u shpërndanë anekënd Kosovës me detyrën e shenjtë që kishin, hapjen e shkollave shqipe dhe zhdukjen e analfabetizmit. Siq e dim bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve ka zgjatë gjatë viteve 1941-1945, dhe për gjithë këto vite në mënyrë

kronologjike kemi dhënë të dhëna tabelare, duke u munduar kështu, të bëjmë një studim të hollësishëm për të parë emrat e të gjithë atyre që dhanë kontribut në zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Duke e parë rëndësinë e zhvillimit të arsimit në të gjitha vendet botërore, padyshim se një rëndësi të madhe për ne ka edhe se si është zhvilluar arsimi tek ne, në Kosovë. Sidomos ne periudhen 1918 – 1924 kur Kosova ishte në rrezik të asimilimit ose shprazjes nga shqiptarët si pasojë e repretizimit të serbëve ndaj tyre. Andaj unë këtë punim e kam ndarë në tre kapituj ku do të paraqesë zhvillimin e arsimit, por bashkë me të edhe jetesën e popullit të Kosovës gjatë viteve 1918 – 1945.

Në kapitullin e parë, Kosova pas Luftës së Parë Botërore, kam parashtruar, gjendjen politike në Kosovë, se si ka qenë në këtë periudhë dhe më çfarë vështirësishë janë përballur populli shqiptarë i Kosovës. Gjithashtu flasim edhe për hapjen e shkollave të para dhe mënyrën se si është zhvilluar arsimi atje deri në vitin 1924 kur merr fund kryengritja kaçake.

Në kapitullin e dytë do shpjegojmë për Arsimit në Kosovë gjatë viteve 1924 – 1940, se si ishte gjendja e shqiptarëve të Kosovës pas shuarjes së kryengritjes së kaçake, mënyra se si u zhvillua arsimit prej vitit 1929 deri më 1939, si dhe pozita e shqiptarëve në Kosovë në prag të Luftës së Dytë botërore.

Në kapitullin e tretë do të tregojmë për fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe pushtimi i Kosovës nga forcat nazi fashiste. Se cilat ishin pasojat për popullin shqiptarë më ardhjen e pushtuesve të rinj, do flasim për hapjen e shkollave të para në gjuhën shqipe, si dhe çfarë pasojash kishte për arsimin shqip pas pushtimit të sërishëm të Kosovës nga forcat jugosllave, përkatësisht komuniste.